

fakte

Dhuna rinore

Dhuna nga ana e njerëzve të rinjë është njëra nga format më të dukshme të dhunës. Edhe sulmet fatale apo jofatale në të cilat janë të kyqur njerëz të rinjë, në masë të madhe kontribuojnë në numrin e përgjithshëm të vdekjeve të parakohshme, lëndimeve dhe invaliditetit. Dhuna rinore në masë të madhe thëllësisht i lëndon jo vetëm viktimat por edhe familjet e tyre, shokët dhe shoqërinë.

Egzistonë lidhje e ngushtë në mes dhunës rinore dhe formave tjera të dhunës. Njerëzit e ri të dhunshëm shpesh herë kryejnë vepra penale të numërta dhe shfaqin probleme të tjera psikologjike dhe sociale.

SHKALLA E PROBLEMIT

Vlerësohet se në vitin 2000 në botë kanë ndodhë rreth 199 000 vrasje rinore – ekuivalentë të vdekjes së 565 fëmijëve dhe të rinjëve me moshë nga 10 deri më 29 vjeq, mesatarisht çdo ditë dhe kjo si rezultat i dhunës ndërpersonale. Por shkalla e vrasjeve rinore dukshëm ndryshon në varësi të rajonit apo shtetit, kurse shkalla e femrave pothuajse gjithkund është më e ulët se shkalla e meshkujve.

Në dekadën e viteve 1985 – 1994 shkalla e vrasjeve rinore u zmadhua në shumë vende të botës. Kjo rritje në raste të shumta lidhet me përdorimin e shpesh të revolveve (pistoletave) si mjet për sulmë.

Vlerësohet se në çdo rast të humbjes së jetës të një të riu në dhunë, 20-40 persona marrin lëndime për të cilët është i nevojshëm kujdesi spitalor.

Lëndimet jofatale të dhunshme përfshijnë në masë të madhe më pak sulme me armë zjarri se sa ato të sulmeve fatale, dhe në këto sulme më së shumti përfshihen grushtat, këmbët, thikat si dhe shkopinjë.

Studimet tregojnë se gjendja e dehurë është një faktor i rëndësishëm situacional i cili mund ta përshpejton dhunën.

Rrahja fizike dhe të frigësuarit janë gjithashtu shumë të zakonshme ndërmjet njerëzve të rinjë. Një studim i kryer tek fëmijët nëpër shkollat në 27 vende zbuloi se në shumicën e tyre, mazhoranca e 13 vjeçarve kanë qenë të përfshirë të paktën ndoherë në frigësimin e dikujt.

CILËT JANË FAKTORËT-RREZIK KRYESOR PËR DHUNË RINORE?

Faktorët individual

Faktorët kryesor të sjellejs të personalitetit të lidhur me dhunën rinore janë:

- hiperaktiviteti,
- impulsiviteti,
- kontroll i ulët ndaj sjellejs,
- probleme me vëmendjen,
- historia e sjellejs agresive të hershme,
- të arritura të ulta arsimore.

Ndikimi prej familjes dhe moshatarve

Atmosfera në shtëpi është qelësi për zhvillimin e sjellejs të dhunshme tek të rinjtë. Disa prej faktorëve kryesor familjar të lidhura me dhunën adoleshente janë:

- mbikëqyrje e keqe e fëmijëve nga ana e prindërve dhe dënime të rënda fizike për disiplinimin e tyre,
- konflikt mes prindërve në fëmijërinë e hershme,
- nivel i ulët i besnikëris mes fëmijës dhe prindërit,
- nënë e cila e ka lindur fëmijën e parë në moshë të re,
- përjetim i përçarjes ose ndarjes së prindërve në moshë të hershme,
- nivel i ulët i kohezionit familjar,
- status i ulët socio – ekonomik i familjes.

Shoqërimi me moshatar delikuent gjithashtu lidhet me dhunën tek personat e rinjë.

Faktorët social, politik dhe kulturor

- Bandet dhe oferta lokale e armëve dhe drogës janë kombinim i mundshëm të cilët i zmadhojnë gjasat e dhunës rinore.
- Niveli i ulët i kohezionit social në shoqëri lidhet me hapa më të larta të dhunës rinore.
- Kualiteti i qeverisjes me shtetin, ligjet e saja si dhe shkalla në të cilën ato zbatohen dhe politika e mbrojtjes sociale kanë një efekt të rëndësishëm mbi dhunën.
- Faktorët si të ardhurat jo të barabarta, ndryshimet e shpejta demografike tek popullata e re dhe urbanizimi, të gjitha këto pozitivisht lidhen me dhunën rinore.
- Kulturat të cilat nuk japin alternativa jo të dhunshme për zgjidhjen e konflikteve duket se kanë shkallë më të lartë të dhunës rinore.



Organizata
botërore
e shëndetësisë



Ministria e
shëndetësis, RM



Enti Republikan
për mbrojtje
shëndetësore



Fondacioni Instituti i
Hapur i Shoqëris Civile
në Maqedoni



Shoqata për emancipim,
solidaritë dhe barazi
gjinore në RM



ÇKA MUND TË BËHËT QË TË PARANDALOHET DHUNA RINORE?

Janë të provuara metoda të ndryshme për parandalimin e sjelljes të dhunshme tek të rinjtë. Intervenimet më të zakonshme kërkojnë ndryshim të shkathësive, qëndrimeve dhe të besuarit ndaj individit. Programe të këtilla shpesh herë janë zbatuar nëpër shkolla dhe përgatiten që t'u ndihmojnë fëmijëve dhe adoleshentëve për menaxhim të hidhërimit, zgjidhjen e konflikteve si dhe të zhvillojnë shkathësit e duhura sociale për zgjidhjen e problemeve.

Grupë tjetër strategjik i zakonshëm për preventim që trajtojnë dhunën rinore koncentrohet në intervenimin e hershëm tek fëmijët dhe familjet. Programet e tilla prindërve ju sigurojnë informacione për zhvillimin e fëmijëve dhe i mësojnë se si efektivisht ti disciplinojnë,

përcjellin dhe mbikqyrin fëmijët si dhe atë se si të udhëhiqen konfliktet në familje dhe të përmirsohet komunikimi. Intervenimet tek prindërit dhe fëmijët janë ndër strategjitë më premtuese për prodhimin e zvogluar afatgjatë të dhunës rinore.

Qasjet tjera fokusohen në shoqërin dhe në disa prej faktorëve shoqëror më të theksuar të lidhura me dhunën rinore. Ato sillen prej fushatave për informim të publikut dhe zhvillimin e politikave të shoqëris deri tek përmirësimi i mjediseve siç janë shkollat dhe spitalet. Këtu janë të kyqura reformat ligjvënse, gjyqësore dhe arsimore si dhe reforma tjera në politikë të cilat janë të paramenduara që t'i lehtësojnë efektet e ndryshimeve të shpejta shoqërore dhe ta adresojnë dhunën e armatosur mes të rinjëve. Por, shumica e këtyre qasjeve nuk janë të vlerësuara.

SHEMBUJ TË STRATEGJIVE PËR PARANDALIMIN E DHUNËS RINORE

Individii	Marrëdhëniet	Bashkësia	Shoqërore
Programe parashkollore për pasurimin e përmbajtjeve ^a	Vizita shtëpiakeve (së bashku me vizita të rregullta nga ana e motrës medicinale ose punëtor tjerë shëndetësor familjeve me nevoja speciale për përkrahje dhe udhëzim në rritjen e fëmijëve dhe kujdesin ndaj tyre)	Përmirësimi i ambientit shkollor duke i përfshir edhe praktikata arsimore, politikat shkollore dhe sigurimin	Fushata për informim të publikut
Programe për zhvillim social (veçanërisht ato që i theksojnë shkathësit sociale dhe kompetencat) ^a	Trajnim për prindër ^a	Programe nëpër shkolla	Përpjekje për zvoglimin e dhunës në medime
Programe për preventimin e frigësimit ^a	Terapi familjare ^a	Aktivitete jashtë programit arsimor	Përforcimi dhe përmirësimi i sistemeve policore dhe gjyqësore
Këshillime ^b	Programe mentorimi ^a	Krijimi i politikës së bashkësis	Reformimi i sistemit arsimor
Orientim profesional	Meditim me moshatar/këshillim të moshatarve ^b	Programe për preventimin e bandeve ^b	Ndryshime në politikat për uljen e varfëris dhe pabarazisë
Stimulanse për të rinjtë me rrezik të lartë për dhunë që të mbarojnë arsimin e mesëm ^a		Modifikimi i ambientit fizik	Aktivitete dhe politika për uljen e efekteve nga ndryshimet e shpejta sociale dhe për ballafaqimin me dhunën e armatosur mes të rinjëve
		Përmirësimi i reagimit në raste urgjente, kujdes traumatik dhe qasje ndaj shërbimeve shëndetësore	
		Trajnim për punëtorët shëndetësor që ti zbulojnë dhe ti udhëzojnë të rinjtë me rrezik të lartë për dhunë	
		Zvoglim i disponueshmëris të alkoolit	

^a Janë treguar si efektive në uljen e dhunës rinore ose faktorëve-rrezik për dhunë rinore

^b Janë treguar si joefektive në uljen e dhunës rinore ose faktorëve-rrezik për dhunë rinore